

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E martë, 1 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja – seksioni dygjuhësh

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në poezi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10a	10b	11	12
Pikët														
Kërkesa	13	14	15	16	17	18	19	20a	20b	20c	21a	21b	21c	22
Pikët														
Kërkesa	23	24	25a	25b	25c	25d								
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****MIGJENI****Studenti në shtëpi (fragment)**

- A t'u mbush mendja me ardhë, - i tha i ati kur e pa. Nushi u mallëngjye pak me të pamun t'anë dhe donte këtë dhe ta diftojë, por i ati vetëm i shtrini dorën, të cilën Nushi e shtrëngoi pa ditë me u përgjegjë në pyetje. Kur u rrok me motra, këto si me u mendue a ta puthin apo jo. Vetëm puthja e s'amës ishte e kuartë dhe oshtini nëpër shtëpi.

- Mamë, - tue kuvendue një mbramje me Nushin thirri Agia, motra e fejueme, dhe shpejtoi tek e ama në dhomë të zjarrmit. Mamë! Nushi thotë se edhe vajzat sa unë, edhe të martueme bile, shkojnë në shkollë. Ha- ha- ha! U përplas qeshja e vajzës në ftyrë të s'amës.

- Mos u qesh ashtu moj bijë, se po të ndijnë kojshijtë... asht marre. Vajza nuk përgjegji, por, e zanun me tregimet e vllaut, mendonte ato vende të çuditshme, ku vajzat nuk lidhen për shtëpi, ku dalin me djelm me shëtitë pa farë turpi, ku kërcejnë...ah! Kërcejnë aq bukur.

Vllau muer motrën dhe filloi t'i kallzojë do rregulla, por ashtu në grykë të shoqi-shoqit dhe tue kërcye, i gjeti i ati.

- S'ke marre! Nesër do të martohesh!... Edhe ti, - tue iu sjell Nushit, - s'je i vogël. Shyqyr që paske ardhë sonte herët! – i tha i ati vranët.

Nushi nuk dinte ç'ka me thanë. Nuk dinte me folë me t'anë. Kur ishte fëmi, e kuptonte shumë ma mirë. Por kaloi ajo kohë, kur në imagjinatën e tij baba ishte diçka më tepër se babë, ishte një ideal, ideal i andrimeve feminare. E sot, e din Nushi, se baba i tij asht një prej qindra – në mos mijatnish të qytetit tonë, njeni prej atyne etënve që nga fmia i vet duhet me bamë një njeri anakronik, pikturën e vet, trashëgimtarin e dej të një të kaluese të zymtë.

E Nushi ndigjon. Don me qenë djal i mirë. Si mos me ndigjue babën i cili e lindi, e rriti, e bani aq. Pale mos dëgjo. Megjithëse kundra ndërgjegjes së vet, Nushi ndigjon. Nga fjalët e t'et i shtrembnohet fytyra, por me ndëgjuë- ndigjon. Ndëgjojnë edhe vllaznit e motrat, të cilat kanë ndejun përreth dhe të gjithë janë bamë vesh. Pale mos ndëgjo. Ndëgjon edhe nana në dhomë të zjarrmit fjalët e burrit të vet dhe me një frigë çuditet për ditunin e madhe të bashkëshortit. Tanë një familje, e mbyllun brenda mureve të shtëpis dhe brenda një ambienti patriarkal, përgatitet për jetën qytetare të nesërme. "Mos të më korisin, - mendon kryetari i familjes, tue i shikue me rend të gjith pjestarët. Mos të më korisin, prandaj shtrëngo frenat, shtrëngo sa të mundesh, e nse nuk mund të marrin frymë – të pëlcastin. Sa vështirë asht me rritë fëmi në kohë të soçme! Sa vështirë është me ruejtë varzat! Eh kohët e kalueme! – Por a e dini ju, morë fëmi, se unë njaq sa ju ishe, kur fillova me fitue bukën...

Nushi ndigjon. Të gjithë ndigjojnë. Pale mos ndëgjo! Nushi ndëgjon dhe mendon. Ndoshta jeta e ka bamë kët njeri kaq të rreptë.

Një buzëmbamje Nushin na e kish zanë nostalgjia për viset e largëta, për qytetin e studimeve të tij. Ai e don kët votër, më mirë me thanë këto gjind rreth votrës: prindit, motrat e vllaznit, por diçka si ma e fortë e lidh për ato vise. Ato vise ku jeta impulsive të lejon ta shijosh dhe si i ri dhe si plak, si filozof ose si njeri i thjeshtë. Nushi vëren kontrastin e tmerrshëm në mes të vendit të vet dhe t'atyne viseve. Dhe si i ri që asht, ndjenjat e tij mnjanojnë për mrekullinat e largëta, e në mendime gjurmon shkaqet pse vendi i tij asht aq mbrapa. Dhe njato shkaqe, me gjithë zjarrin e rinisë, i urren. Urren të kaluemen që asht aq e afërme, si baba i tij. Baba asht i afërm, si babë, por i largët si përfaqësues i shoqnisë, si person. E gjithë mosmarrëveshja, të gjitha moskuptimet vijnë ngase të gjith kemi nëpër shtëpia, nëpër votra, ka një ose ma tepër të këtitllë të dashtun dhe t'urrejtun përnjëherësh. Nushi e din që dhe baba i tij s'ka faj se asht i tillë; rrethanat dhe shoqnia e krijuen. Prandaj dhe ka mbetun dashuria birnore në Nushin, pse din të arsyetojë. Por vllaznit e tij, motrat, a thue do ta dojnë babën? Kujtohet se kur ishte fëmi, kundrejt babës ma parë ndiente frigë se dashuni. E tash motrat dridhen para babës, e vllaznit nuk e kanë aspak në qejf shoqnin e babës: kur vjen baba ata zhduken.

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. I gjithë raporti atë-bir përmbledhet në fjalët: **1 pikë**
- A) përulje – frikë  
 B) respekt – mirëkuptim  
 C) adhurim – ndrojtje  
 D) dashuri – urrejtje
2. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur ironia? **1 pikë**
- A) Pale e mos ndëgjo!  
 B) S'ke marre! Nesër do të martohesh!  
 C) Mos të më korisin, prandaj shtrëngo frenat,  
 D) Sa vështirë asht me rritë fëmi në kohë të soçme!
3. “Studenti në shtëpi” është: **1 pikë**
- A) rrëfenjë  
 B) prozë poetike  
 C) novelë  
 D) skicë
4. Shqetësimi më i madh i babait të Nushit është: **1 pikë**
- A) mirëqenia e familjes  
 B) nderi i familjes  
 C) edukimi i fëmijëve  
 D) sigurimi i bukës së përditshme.
5. Fjala *buzëmbremje* është: **1 pikë**
- A) e thjeshtë  
 B) e përbërë  
 C) e përngjitur  
 D) e prejardhur
6. Në fjalinë “... nga *fmia* i vet duhet me *bamë një njeri anakronik*” fjala *anakronik* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) i paditur  
 B) i vjetruar  
 C) i vrazhdë  
 D) i shtirur
7. Cila është një nga cilësitë që i mungon nënës së Nushit? **1 pikë**
- A) E duruar  
 B) E përkushtuar  
 C) E përulur  
 D) Me personalitet të fortë

8. Ç'tipare të karakterit të babait të Nushit ka theksuar autori dhe pse? **2 pikë**

---



---

9.

a) Çfarë e bën të veçantë personazhin e motrës së Nushit? Ku dallon ajo nga nëna e saj? **2 pikë**

---



---

b) Çfarë e afron dhe largon Nushin nga i ati? **1 pikë**

---

10.

a) Migjeni nuk është vetëm një vëzhgues i thjeshtë i situatave, por edhe komentues e vlerësues. Gjeni një rast ku ai shfaqet i tillë në fragment dhe jepni mendimin tuaj lidhur me të. **2 pikë**

---



---

b) Shpjegoni situatën paradoksale dhe nëntekstin ironik që Migjeni jep kur pohon se:

*Tanë një familje, e mbyllun brenda mureve të shtëpis dhe brenda një ambienti patriarkal, përgatitet për jetën qytetare të nesërme.*

**2 pikë**

---



---



---

11. Marrëdhëniet brenda familjes së Nushit janë tipike patriarkale. Identifikoni dy momente ku shfaqet patriarkalizmi. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

12. Pse Nushi ndihet më mirë në vende të huaja se në shtëpinë e vet? Jepni të paktën dy arsye që shkaktojnë këtë ndjenjë tek ai. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

13. Në këtë fragment vëmë re përdorimin e përsëritur të një foljeje (paragrafi 3 dhe 4). Cila është ajo? Çfarë ka dashur të theksojë autori përmes këtij përdorimi? **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**PJESA II****Aleksandër Pushkin****Eugjen Onjegin**

Po marr guximin t'ju shkruaj...  
 Ç'do deshnit më veç shpirtit tim?  
 E di, se është e drejta juaj  
 Të më dënoni me përçmim.  
 Po ju që shihni si po vuaj  
 Me pak mëshirë, sado pak  
 Nuk do më sprapsni zemërak!  
 Më parë desha të rri e qetë;  
 Për turpin tim, besomëni:  
 Ju s'do të dinit kurrë sesi,  
 Po të mund të shpresoja vetë,  
 Që kur e kur me plot hare,  
 Të kem t'ju shoh këtu tek ne,  
 Që t'ju dëgjoj si kuvendoni,  
 T'ju them një fjalë dhe pastaj  
 ne zemër veç një mall të mbaj,  
 veç gjer sërish të më takoni...  
 po thonë se ju s'rrini dot:  
 në fshat,  
 na gjetët tek ky vend i qetë?  
 T'ju njoh s'do kisha kurrë fat,  
 S'do kisha turbullim' e shkretë.  
 Duk u qetuar (kushedi),  
 Një miku mund t'i bëhesha mike  
 Dhe shoqe e jetës dhe besnike,  
 Dhe zonj' e ndershme për shtëpi,  
 një tjetër...Jo askujt në jetë  
 nuk do t'i falnja dashuri!  
 E ka vendosur Qielli vetë,  
 jam e jotja në përjetësi!  
 Gjithë jeta ime më pat qenë  
 Një peng se ty do të takoj;  
 Se Zoti jetën ma ka dhënë  
 Gjer në varr të t'adhuroj...

Përhera të kam ëndërruar;  
 Të ndjeja thellë mu në gjit,  
 Me at vështrim që më trondit.  
 Në zemër shpesh ta kam dëgjuar  
 Ty zërin...

Jo s'ish ëndërrim!  
 Dhe sapo hyre, të kuptova,  
 Më preke, fort u përvëlova,  
 Thashë është ai thesari im!  
 S'është e vërtetë? Po, të kam ndier;  
 Më flisje; kur me dhemshuri  
 Ndhimjoja njerëzit e mjerë  
 Më sillte lutja qetësi.  
 Edhe tani, ndaj kësaj grime,  
 A nuk je ti, o ëndrra ime,  
 Që n'errësirë po ndriçon  
 E vjen më prek plot nur e hije?  
 S'je ti që plot prej dashurie  
 Shpres' edhe gas më numëron?  
 Kush je ti? Engjëlli me shpresë,  
 Apo një lajkatar pa besë?  
 Ma hiq tani këtë dyshim;  
 Kjo mbase një ëndërr mund të jetë,  
 Për zemrën time një gënjim,  
 E ndryshe krejt fat' i vërtetë...  
 Po dhe kështu. Jet' edhe fat  
 Veç ty që sot t'i kam besuar,  
 Më qan me lot shpirti i ngratë  
 E mbrojtje vij për të kërkuar...  
 Mendo: jam vetëm, s'kam ku flas,  
 Askush nuk mund të më kuptojë  
 Mendja fillon të më lëshojë,  
 Në heshtje duhet të humbas.  
 Të pres: ti eja siç më k'ënda  
 Dhe shpresat ngjallmi përsëri,  
 A ma prish ëndrrën që tani  
 Me të qetuara të rënda!  
 Mbarova! S'mund ta rilexoj...  
 Po vdes nga frik' e turpëruar...  
 Po nderit tuaj i besoj,  
 Me plot guxim duke shpresuar...

Për pyetjet nga 14 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.

14. Nga mënyra se si Tatjana shpalos ndjenjat e saj në letër, ne kuptojmë se ajo: **1 pikë**

- A) pranon më mirë të gënjejhet se të humbasë dashurinë e saj.
- B) pranon më mirë të humbasë dashurinë se të gënjejhet.
- C) është e bindur se Onjegini s'ë dashuron, por ndjek ndjenjën e saj.
- D) është e bindur në dashurinë e Onjeginit dhe guxon ta hedhë vetë hapin e parë.

15. Me veprën “Eugjen Onjegini” Pushkini konsiderohet si nismëtar: **1 pikë**

- A) i sentimentalizmit
- B) i realizmit
- C) i modernizmit
- D) i klasicizmit

16. Në veprën "Eugjen Onjegini" Pushkini pasqyron: **1 pikë**

- A) përjetimin e një dashurie fataliste.
- B) përditshmërinë e aristokratëve të rënë nga vakti.
- C) përpjekjet për të ndryshuar realitetin e rënduar rus të kohës.
- D) udhëkryqin në të cilin ndodhet rinia ruse.

17. Vepra "Eugjen Onjegini" është: **1pikë**

- A) novelë
- B) prozë poetike
- C) roman në vargje
- D) tregim

18. Toni me të cilin Tatjana i drejtohet Onjeginit merr karakter lutës në vargun: **1 pikë**

- A) T`ju njoh s`do kisha kurrë fat
- B) Dhe shpresat ngjallmi përsëri
- C) Po marr guximin t`ju shkruaj
- D) Më preke, fort u përvëllova

19. Rrëfimi i Tatjanës në letër përshkohet nga: **1 pikë**

- A) besimi në realizimin e ëndrrës së saj.
- B) guximi i moshës.
- C) siguria e një dashurie të ndërsjellë.
- D) zhgënjimi i një miqësie.

20. Gjeni vargjet ku Tatjana paraqet vetminë e saj. Cila është arsyeja e kësaj vetmie dhe ç' gjendje shpirtërore i krijon ajo heroinës?

a) vargjet: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) arsyeja: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) gjendja shpirtërore: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

21.

- a) Cili është raporti kontekstual që krijojnë midis tyre fjalët e nënvizuara në vargjet e dhëna më poshtë? **1 pikë**

*Engjëlli me shpresë,  
Apo një lajkatar pa besë?*

---

- b) Gjeni foljen në vargun: “për turpin tim, besomëni”. Cili është qëllimi i përdorimit të foljes në numrin shumës? **2 pikë**

---



---

- c) Në këtë fragment vihet re një përdorim i dendur i pyetjeve retorike. Cili mendoni se është funksioni i tyre? **1 pikë**

---

22. Cili është raporti i Tatjanës me mjedisin në të cilin jeton? Çfarë vlerëson dhe çfarë qorton ajo nga ky mjedis? **3 pikë**

---



---

23. Subjekti i poemës ndërtohet mbi një dramë tipike romantike, por kritika e vlerëson për të tjera motive. Shkruani dy karakteristika të veprës së Pushkinit, që shënuan risi në letërsinë ruse të kohës.

**2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

24. Si do t’i interpretonit katër vargjet e fundit të “Letrës”? Ç’gjendje psikologjike zbulojnë ato? **2 pikë**

*Mbarova! S’mund ta rilexoj...  
Po vdes nga frik’ e turpëruar...  
Po nderit tuaj i besoj,  
Me plot guxim duke shpresuar...*

---



---

